Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 5 prill 2012

Lëndët nr. 122/09 M.S.; 157/09 Radivoje RADISAVLEVIQ; 184/09 Ollivera ÇUPIQ; 192/09 Bogolub SHMIGIQ; 193/09 Millijana VUKSANOVIQ; 202/09 Millorad PEJÇINOVIQ; 204/09 Millan PETROVIQ; 337/09 Vinka POPOVIQ; 347/09 Predrag MIRIQ; 348/09 Zoran LUSHIQ; 66/10 Sllobodan PILLISHER

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 5 prill 2012, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas konsiderimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në përputhje me rregullën 13 § 2 të Rregullores së tij të punës, vendosë si në vijim

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa e M.S. (lënda nr. 122/09) është parashtruar më 23 prill 2009 dhe është regjistruar më 30 prill 2009; ankesa e z. Radivoje Radisavleviq (lënda nr. 157/09) është parashtruar më 10 prill 2009 dhe është regjistruar më 30 prill 2009; ankesa e z. Ollivera Çupiq (lënda nr. 184/09) është parashtruar dhe regjistruar më 30 prill 2009; ankesa e z. Bogolub Shmigiq (lënda nr. 192/09) është parashtruar më 9 prill 2009 dhe është regjistruar më 30 prill 2009; ankesa e znj. Millijana Vuksanoviq (lënda nr. 193/09) është parashtruar më 14 prill 2009 dhe është regjistruar më 30 prill 2009; ankesat e zotërinjve Millorad Pejçinoviq (lënda nr. 202/09) dhe Millan Petroviq (lënda nr. 204/09) janë parashtruar më 8 prill 2009 dhe janë regjistruar më 30 prill 2009; ankesa e znj. Vinka Popoviq (337/09) është parashtruar më 10 prill 2009 dhe është regjistruar më 14 dhjetor 2009; ankesa e z.

Predrag Miriq (347/09) është parashtruar dhe regjistruar më 15 dhjetor 2009; ankesa e z. Zoran Lushiq (348/09) është parashtruar më 23 prill 2009 dhe është regjistruar më 30 prill 2009 dhe ankesa e z. Sllobodan Pillisher (66/10) është parashtruar më 1 prill 2010 dhe është regjistruar më 14 prill 2010.

2. Ankuesi z. Pillisher ka vdekur në mars të vitit 2012. Më 4 prill 2012. Znj. Snezhana Pillisher, e veja e tij, ka informuar Panelin për qëllimin e saj që të vazhdojë procedurën ankimore. Për arsye praktike, Paneli do të vazhdojë të quajë z. Sllobodan Pillisher si ankues, edhe pse ky kapacitet tani duhet t'i bartet znj. Snezhana Pillisher.

II. FAKTET

3. Të gjithë ankuesit janë ish-banor të Kosovës që aktualisht jetojnë në Serbi, me përjashtim të z. Pejçinoviq dhe z. Petroviq, të cilët vazhdojnë të jetojnë në Kosovë. Të gjithë ankuesit kanë qenë pronar të pronës së patundshme në Kosovë. Ata kanë jetuar aty deri në vitin 1999, kur, me përjashtim të z. Pejçinoviq dhe të z. Petroviq, ata shkuan nga Kosova. Më vonë, ata kuptuan se prona e tyre ishte dëmtuar apo shkatërruar gjatë pjesë së dytë të vitit 1999.

4. Ankuesit M.S., z. Pejçinoviq dhe z. Miriq kanë parashtruar kërkesëpaditë e tyre tek gjykatat kompetente kundër UNMIK-ut, KFOR-it, Institucioneve të përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ) dhe komunave përkatëse, përmes të cilave kërkonin kompensim për dëmtimin e shkaktuar ndaj pronave të tyre. Ankuesit e tjerë kanë parashtruar kërkesëpaditë e tyre vetëm kundër komunave përkatëse dhe IPVQ-ve. Të gjitha kërkesëpaditë janë parashtruar në vitin 2004.

5. Deri në fund të vitit 2008 gjykatat nuk kanë kontaktuar e ankuesit dhe nuk është caktuar ndonjë seancë gjyqësore.

6. Përafërsisht 17.000 kërkesëpadi për kompensim janë parashtruar para gjykatave të Kosovës në vitin 2004, ku pjesa më e madhe e tyre janë parashtruar nga serbët etnikë, të cilët për shkak të armiqësive kishin lëshuar shtëpitë e veta në Kosovë në vitin 1999, dhe prona e të cilëve më vonë është dëmtuar apo shkatërruar. Me qëllim të respektimit të afatit pesëvjeçar të parashkrimit të dorëzimit të padive civile për kompensim, këta kërkesëpaditës i parashtruan kërkesëpaditë e tyre para gjykatave të Kosovës përafërsisht në të njëjtën kohë gjatë vitit 2004. Kërkesëpaditë parashtroheshin kundër UNMIK-ut, KFOR-it dhe IPVQ-ve, si dhe kundër komunës përkatëse (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (më tutje në tekst PKDNj), *Millogoriq dhe të tjerët*, lëndët nr. 38/08, 58/08, 61/08, 63/08 dhe 69/08, Mendimi i 24 marsit 2010, § 1; lidhur me bazën ligjore, mbi të cilën paditësit e bazuan kërkesëpadinë e tyre, shih Mendimin e njëjtë, § 5).

7. Lidhur me këto lëndë, më 26 gusht 2004, drejtori i Departamentit të Drejtësisë (DD) të UNMIK-ut u dërgoi letër të gjithë kryetarëve të gjykatave komunale dhe të atyre të qarkut, si dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Në letër, drejtori i DD-së theksoi se janë parashtruar mbi "14 000 kërkesëpadi" të tilla. Ai iu referua "problemeve që një numër kaq i madh i kërkesëpadive paraqet për gjykatat" dhe kërkoi që "për asnjë lëndë të tillë të mos caktohet seancë gjyqësore, deri kur bashkërisht të vendosim për mënyrën më të mirë të procedimit të këtyre lëndëve" (tekstin e plotë të letrës mund ta shihni në Mendimin për lëndën *Millogoriq dhe të tjerët*, të cituar në § 6 më lartë, § 6).

8. Më 15 nëntor 2005, DD-ja i ftoi gjykatat që të fillojnë me procedimin e kërkesëpadive për dëme, të shkaktuara nga personat e identifikueshëm fizikë dhe për dëmet e shkaktuara pas tetorit të vitit 2000, duke konsideruar që "pengesat për procedimin efikas të këtyre lëndëve" tani më nuk ekzistonin. Kërkesëpaditë e ndërlidhura me ngjarjet para tetorit 2000 nuk janë trajtuar përmes kësaj letre.

9. Më 28 shtator 2008, drejtori i DD-së i këshilloi gjykatat se lëndët që nuk janë caktuar në bazë të kërkesës së 26 gushtit 2004, tani duhet të procedohen.

10. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut për gjyqësorin e Kosovës përfundoi dhe Misioni për Sundim të Ligjit i Bashkimit Evropian (EULEX) morri kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), përmes së cilës mirëpritet angazhimi i vazhdueshëm i Bashkimit Evropian në Kosovë.

11. Rrethanat e lëndëve veç e veç për këtë çështje janë të përshkruara në shtojcën e këtij vendimi.

III. ANKESAT

12. Në thelb, ankuesit pohojnë se gjykatat përkatëse kanë pezulluar procedurat lidhur me paditë për dëmet ndaj pronës dhe si rrjedhojë këto procedura nuk kanë përfunduar brenda një kohe të arsyeshme, gjë që paraqet shkelje të nenit 6 § 1të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj). Ata pohojnë se për të njëjtën arsye, e drejta e tyre në mjet të efektshëm juridik për zgjidhjen e kontestit sipas nenit 13 të KEDNj-së gjithashtu është shkelur.

13. Ankuesit më tej ankohen se përmes shkatërrimit të pronës së tyre dhe nga refuzimi i gjykatave kompetente për të marrë vendim rreth kërkesëpadive të tyre për dëme, është shkelur e drejta e tyre në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNj-së).

IV. BASHKIMI I ANKESAVE

14. Paneli vendosi që në pajtim me rregullën 20 të Rregullores së tij të punës, t'i bashkojë të gjitha ankesat.

V. APLIKIMI I RREGULLËS 29*BIS* TË RREGULLORES SË PUNËS SË PANELIT

15. Paneli më tej thekson se ankesat në fjalë ngrisin çështje që në thelb janë të njëjta me ato që janë ngritur, në mes të tjerash, në lëndët me nr. 38/08, Millogoriq, 58/08, Zhivaleviq, 61/08, Gojkoviq, 63/08 Qukiq dhe 69/08, Bogiqeviq, të cilat Paneli i ka shqyrtuar. Për më tepër, nga elementet e dosjeve duket se nuk ka dalë ndonjë çështje e re lidhur me aspektin e pranueshmërisë sa i përket këtyre lëndëve. Rrjedhimisht, në pajtim me Rregullën 29 *bis* të Rregullores së punës të Panelit, Paneli mendon se nuk ka nevojë që këto ankesa t'ia komunikojë

UNMIK-ut dhe se mund të shqyrtojë pranueshmërinë e ankesave pa bërë një gjë të tillë.

VI. LIGJI

16. Para se të merren parasysh lëndët lidhur me bazueshmërinë e tyre, Paneli duhet të vendosë nëse duhet të pranohen këto lëndë, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë, të paraqitura në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006.

Shkelja e pretenduar e neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNj-së

17. Paneli konsideron se për aq sa ankuesit thirren në shkeljen e neneve 6 § 1 dhe 13 të KEDNj-së, ata në fakt paraqesin dy ankesa (shih qasjen e zbatuar në PKDNj, *Millogoriq*, nr. 38/08, vendimi i datës 22 maj 2009; krahaso Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj), *Aqimoviq kundër Kroacisë*, nr. 48776/99, vendimi i datës 30 maj 2000; GJEDNj, *Kutiq kundër Kroacisë,* nr. 48778/99, vendimi i datës 11 korrik 2000). Në njërën anë ata ankohen për faktin se për shkak të pezullimit të procedurave në gjykatat kompetente, ata nuk kanë qenë në gjendje të marrin vendimin për paditë e tyre lidhur me dëmtimet e pronave. Paneli konsideron se kjo ankesë mund të ngritë çështjen të së drejtës së tyre për qasje në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të KEDNj-së dhe të së drejtës së tyre për mjet të efektshëm juridik sipas nenit 13 të KEDNj-së. Ndërsa, në anën tjetër, ata ankohen për kohëzgjatjen e procedurës para gjykatave kompetente, për shkak të faktit se procedurat kanë filluar në vitin 2004 (apo në rastin e z. Rama, në vitin 2005) dhe se paditë e tyre nuk janë shqyrtuar që atëherë. Kjo ankesë mund të ngritë çështjen e të drejtës së tyre për vendim gjyqësor brenda kohës së arsyeshme, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNj.

18. Paneli konsideron se ankesat sipas nenit 6 § 1 dhe 13 të KEDNj-së ngrisin çështje serioze të fakteve dhe të ligjit, përcaktimi i të cilave duhet të varet nga shqyrtimi i bazueshmërisë. Rrjedhimisht, Paneli vjen në përfundim se këto nakesa në shikim të parë nuk janë të pabazuara sipas nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 (shih në mes të tjerash, *Millogoriq*, cituar në § 18 më lartë, në § 18).

19. Nuk është përcaktuar ndonjë bazë tjetër për shpalljen e këtyre ankesave si të papranueshme.

Shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së

20. Të gjithë ankuesit ankohen për shkeljen e së drejtës së tyre në pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1). Ata në përgjithësi ankohen për faktin se prona e tyre është dëmtuar apo shkatërruar dhe për dështimin e gjykatave kompetente për të marrë vendim rreth kërkesëpadive të tyre për dëme.

21. Paneli përkujton se në bazë të nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ka juridiksion vetëm për "ankesat që ndërlidhen me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur jo më herët se më 23 prill 2005 apo që kanë dalë nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date, në rastet kur këto fakte kanë për

rrjedhojë shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Dëmtimi apo shkatërrimi i pronës janë akte të atypëratyshme, të cilat nuk rezultojnë me shkelje të vazhdueshme (shih PKDNj, *Llajoviq*, nr. 09/08, vendimi i datës 16 korrik 2008, § 7). Rrjedhimisht, kjo pjesë e ankesave nuk hynë në kuadër të juridiksionit *ratione temporis* të Panelit.

22. Lidhur me ankesën se për shkak të pezullimit të procedurave të nisura nga ankuesit, deri më tani nuk kanë mundur të marrin kompensimin për dëmin, Paneli thekson se për aq sa procedurat gjyqësore ceken nga pikëpamja e së drejtës në pronë, këto procedura nuk mund të ndahen nga aktet, në të cilat bazohen paditë para gjykatave. Apo, për të deklaruar në aspektin pozitiv, siç ka bërë Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut lidhur me juridiksionin e saj sipas KEDNj-së:

> "… Juridiksioni kohor i Gjykatës duhet të përcaktohen në lidhje me faktet që përbëjnë ndërhyrjen e pohuar. Mosshfrytëzimi pasues i mjeteve juridike të parapara për trajtimin e ndërhyrjes nuk mund ta sjellin atë para juridiksionit kohor të gjykatës" (GjEDNj (Dhoma kryesore), *Blleçiç kundër Kroacisë*, nr. 59532/00, aktgjykimi i datës 8 mars 2006, § 77, *KEDNj*, 2006-III).

23. Rrjedhimisht del se kjo pjesë e ankesave gjithashtu nuk hyn në kuadër të juridiksionit *ratione temporis* të Panelit (shih PKDNj, *Gojkoviq*, nr. 63/08, vendim i datës 4 qershor 2009, §§ 24-25).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

- SHPALL SI TË PRANUESHME ANKESAT LIDHUR ME TË DREJTËN NË QASJE NË GJYKATË DHE TË DREJTËN NË MJET TË EFEKTSHËM JURIDIK (NENET 6 § 1 DHE 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT) DHE LIDHUR ME TË DREJTËN PËR VENDIM GJYQËSOR BRENDA KOHËS SË ARSYESHME (NENI 6 § 1 I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT)

- SHPALL SI TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESAVE.

Andrey Antonov
Ushtruese e detyrës së zyrtares ekzekutive

Marek NOWICKI
Kryesues

Shtojca

Lënda nr. 122/09, M.S

1. Ankuesi është ish-banor i Kosovës që aktualisht jeton në Serbi.

2. Ai është pronar i një banese që gjendet në komunën e Kaçanikut, ku ka jetuar deri në vitin 1999. Me rastin e vizitës në pronën e tij para korrikut 2004, ai kuptoi se e njëjta ishte uzurpuar dhe dëmtuar. Ai deklaron se prona e tij është uzurpuar gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

3. Më 7 korrik 2004, ankuesi ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Kaçanikut kundër komunës së Kaçanikut, IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, përmes së cilës kërkonte kompensimin për dëmet ndaj pronës së tij. Ai kërkon 11.600 euro si kompensim për këtë dëm.

4. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 157/09, Radivoje RADISAVLEVIQ

5. Ankuesi është ish-banor i Kosovës që aktualisht jeton në Serbi.

6. Ankuesi është bashkëpronar i një shtëpie, objekteve përcjellëse, tokës, bagëtisë, pemishtes dhe i malit që gjenden në komunën e Podujevës, ku ka jetuar deri në prill të vitit 1999. Në dhjetor të vitit 2003, miqtë e kanë njoftuar prona i është shkatërruar në pjesën e dytë të vitit 1999.

7. Më 8 qershor 2004, ankuesi ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Podujevës kundër komunës së Podujevës dhe IPVQ-ve, përmes së cilës kërkonte kompensimin për dëmet ndaj pronës së saj. Ai kërkon 775.000 euro si kompensim për këtë dëm.

8. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 184/09, Ollivera ÇUPIQ

9. Ankuesja është ish-banore e Kosovës që aktualisht jeton në Serbi.

10. Ankuesja është pronare e një banese që gjendet në komunën e Pejës, ku ka jetuar me familjen e saj deri në vitin 1999. Në vitin 2003 ajo është njoftuar se prona e saj është plaçkitur dhe uzurpuar.

11. Më 26 maj 2004, ankuesja ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Pejës kundër komunës së Pejës dhe IPVQ-ve, përmes së cilës kërkonte kompensimin për dëmet ndaj pronës së saj. Ajo kërkon 20.000 euro si kompensim për këtë dëm.

12. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesen dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 192/09, Bogolub SHMIGIQ

13. Ankuesi është ish-banor i Kosovës që aktualisht jeton në Serbi.

14. Ankuesi është bashkëpronar i një shtëpie, objekteve përcjellëse, pemishtes, malit dhe i tokës që gjenden në komunën e Skenderajt, ku ka jetuar me familje deri në qershor të vitit 1999. Në vitin 2000, miqtë e kanë njoftuar se prona e tij ishte shkatërruar gjatë pjesë së dytë të vitit 1999.

15. Më 20 maj 2004, vëllai i ankuesit ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Skenderajt kundër komunës së Skenderajt dhe IPVQ-ve, përmes së cilës kërkonte kompensimin për dëmet ndaj pronës së saj. Ai kërkon 500.000 euro si kompensim për këtë dëm.

16. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

17. Në vitin 2011, vëllai i ankuesit ka vdekur, dhe ankuesi ka vazhduar të përfaqësojë bashkëpronarët e tjerë lidhur me kërkesëpadinë.

Lënda nr. 193/09, Millijana VUKSANOVIQ

18. Ankuesja është ish-banore e Kosovës që aktualisht jeton në Serbi.

19. Ankuesja është bashkëpronare e dy shtëpive, objekteve përcjellëse, pemishtes, veturës dhe tokës që gjenden në komunën e Pejës, ku ka jetuar me familje deri në qershor të vitit 1999. Në vitin 2003, ajo është njoftuar se prona e saj ishte shkatërruar gjatë pjesë së dytë të vitit 1999.

20. Më 13 dhjetor 2004, nëna e ankueses ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Pejës kundër komunës së Pejës dhe IPVQ-ve, përmes së cilës kërkonte kompensimin për dëmet ndaj pronës së saj. Nëna e ankueses kërkon 170.000 euro si kompensim për këtë dëm.

21. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesen dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 202/09, Millorad PEJÇINOVIQ

22. Ankuesi është banor i Kosovës që aktualisht jeton në Kosovë.

23. Ankuesi është pronar i shtëpive, objekteve përcjellëse dhe tokës që gjenden në komunën e Pejës, ku ka jetuar me familje deri në qershor të vitit 1999. Në vitin 2003, ai është njoftuar se prona ishte shkatërruar gjatë pjesë së dytë të vitit 1999.

24. Më 29 qershor 2004, ankuesi ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Pejës kundër komunës së Pejës dhe IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, përmes së cilës kërkonte kompensimin për dëmet ndaj pronës së tij. Ai kërkon 324,958 euro si kompensim për pronën e tij.

25. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 204/09, Millan PETROVIQ

26. Ankuesi është banor i Kosovës që aktualisht jeton në Kosovë.

27. Ankuesi është pronar i një shtëpie dhe i një banese që gjenden në komunën e Prizrenit, ku ka jetuar deri në qershor të vitit 1999. Ai kishte kuptuar se prona e tij ishte shkatërruar gjatë pjesës dytë të vitit 1999.

28. Më 9 qershor 2004, ankuesi ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Prizrenit kundër komunës së Prizrenit dhe IPVQ-ve, përmes së cilës kërkonte kompensimin për dëmet ndaj pronës së tij. Ai kërkon 69,120 euro si kompensim për këtë dëm.

29. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 337/09, Vinka POPOVIQ

30. Ankuesja është ish-banore e Kosovës që aktualisht jeton në Serbi.

31. Ankuesja është pronare e një banese që gjendet në komunën e Pejës, ku ka jetuar me familje deri në qershor të vitit 1999. Në vitin 2003, ajo është njoftuar se prona e saj është uzurpuar gjatë pjesë së dytë të vitit 1999.

32. Më 1 dhjetor 2004, ankuesja ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Pejës kundër komunës së Pejës dhe IPVQ-ve, përmes së cilës kërkonte kompensimin për vjedhjen e gjërave të vlefshme nga banesa dhe për uzurpimin e pronës. Ajo kërkon 27.000 si kompensim për këtë dëm.

33. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesen dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 347/09, Predrag MIRIQ

34. Ankuesi është ish-banor i Kosovës që aktualisht jeton në Serbi.

35. Ankuesi është pronar i një shtëpie dhe i një prone tjetër për afarizëm që gjenden në komunën e Prishtinës, ku ka jetuar me familje deri në qershor të vitit 1999. Fqinjët e kanë informuar se prona ishte uzurpuar gjatë pjesës dytë të vitit 1999.

36. Më 2 gusht 2004, ankuesi ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Prishtinës kundër komunës së Prishtinës dhe IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe KFOR-it, përmes së cilës kërkonte kompensimin për uzurpimin e pronës së tij dhe për dëmtimin e pretenduar fizik nga pjesëtarët e UÇK-së. Ai kërkon 1.500.000 euro si kompensim për këtë dëm.

37. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 348/09, Zoran LUSHIQ

38. Ankuesi është ish-banor i Kosovës që aktualisht jeton në Serbi.

39. Ankuesi është pronar i një shtëpie dhe i tokës që gjenden në komunën e Istogut, ku ka jetuar deri në vitin 1999. Ai ka kuptuar se pronat e tij janë shkatërruar gjatë pjesës dytë të vitit 1999.

40. Më 25 maj 2004, ankuesi ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Istogut kundër komunës së Istogut dhe IPVQ-ve, përmes së cilës kërkonte kompensimin për shkatërrimin e pronës së tij. Ai kërkon 200.000 euro si kompensim për këtë dëm.

41. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.

Lënda nr. 66/10, Sllobodan PILLISHER

42. Ankuesi është ish-banor i Kosovës që ka jetuar në Serbi deri në vdekjen e tij, në mars të vitit 2012. znj. Snezhana Pilisher, e veja e tij, ka informuar Panelin se ka për qëllim të mbes prapa ankesës.

43. Ankuesi ka qenë pronar i një shtëpie që gjendet në komunën e Prishtinës, ku ka jetuar me familjen e vet deri në qershor të vitit 1999. Në vitin 2000 ai është njoftuar se çdo pronë e luajtshme në banesën e tij ishte marrë gjatë pjesës së dytë të vitit 1999.

44. Më 29 maj 2004, ankuesi ka paraqitur padi për kompensim para Gjykatës komunale të Prishtinës kundër komunës së Prishtinës dhe IPVQ-ve, përmes së cilës kërkonte kompensimin për shkatërrimin e pronës së tij. Ai kërkon 43.950 euro si kompensim për këtë dëm.

45. Deri në fund të vitit 2008, Gjykata komunale nuk ka kontaktuar ankuesin dhe nuk është caktuar ndonjë seancë dëgjimore.